



Republika e Kosovës
Komuna Drenas
Zyra e Kryetarit
01 Nr: 03061-56744 datë 30.12.2020

Raporti i punës nga ZBGj Drenas
Janar -Dhjetor 2020

ZBGJ/Komuna Drenas duke u bazuar në kërkesën e datës 23.12.2020, për dorëzimin e raportit janar-dhjetor 2020 Agjencisë për Barazi Gjinore lidhur me raportimin e Komunave, përkatësisht Zyrtarëve për Barazi Gjinore, bën këtë raport të punës të realizuar për vitin 2020.

Me rastin e 8 Marsit, Ditës Ndërkombëtare të Gruas, në sallën e Kuvendit Komunal është mbajtur një takim i organizuar nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport me të gjitha punonjëset e administratës komunale, të cilave iu janë dhuruar edhe buqeta me lule. Gjatë këtij takimi Kryetari Lladrovci ka theksuar se Komuna e Drenasit mbetet komunë lidere sa i përket besimit në aftësitë dhe shkathhtësitë e grave, ku 6 nga gjithsej 12 drejtori udhëhiqen nga gratë/femrat, ndërsa pjesa dërrmuese e stafit të administratës komunale janë femra.

Qendra për promovimin e të Drejtave të Grave (QPDG) kishte për vizitë një grup të Grave nga Komuna e Obiliqit me iniciativën e Ganimete Aliu (zyrtare për barazi gjinore në Komunën e Obiliqit) dhe gra aktiviste nga shoqëria civile në të cilin takim ishim edhe ne . Qëllimi i këtij takimi ishte njoftimi nga afër me punën dhe aktivitetet e QPSDG-së, e gjithashtu u theksua edhe se ngritja e vetëdijes dhe shmangia e stigmatizimit ndaj të mbijetuarave të dhunës seksuale gjatë luftës vazhdon të jetë ende e nevojshme edhe sot.

Sa i përket masës afirmative për regjistrimin e pronës së paluajtshme në emër të dy bashkëshorteve nga Janari i vitit 2020 deri në Dhjetor të vitit 2020, në Drejtorinë për Gjeodozi, Kadastër dhe Pronë janë paraqitur 41 kërkesa për regjistrimin e pronës në emër të të dy bashkëshortëve., ndërsa në posedim individual dhe pronësi individuale janë gjithësej 13 kërkesa në emër të femrave .



Komuna e Drenasit ka shënuar muajin e ndërgjegjesimit për kancerin e gjirit. Zyra për Barazi Gjinore Komuna Drenas në bashkëpunim me QPDG me Drejtoreshen Kadire Tahiraj dhe QKMF radiologun Shkelzen Gashi kemi mbajtur një sesion informues lidhur me kancerin e gjirit. Sesioni është hapur nga zyrtarja për barazi gjinore pastaj radiologu i cili në mënyrë më të hollësishme ka informuar në hollësi lidhur me zbulimin e hershëm të kancerit të gjirit dhe rëndësinë e shëndetit lidhur me këtë sëmundje .Në këtë sesion informues përveq zyrtarëve nga Komuna kanë marrë pjesë edhe shoqëria civile .

Gjithashtu të gjithë pjesëmarrësve iu është shpërndarë fjongo ngjyrë rozë e cila paraqet simbol ndërkombëtar të ndërgjegjesimit ndaj kancerit të gjirit dhe i mbështetjes së personave që vuanin nga kjo sëmundje. Qëllimi i këtij sesioni informues ishte ndërgjegjësimi i qytetarëve për rrezikun nga kanceri i gjirit



Me datë 06 tetor 2020 Drejtoria për Zhvillimit Ekonomik Zyrtarja për Barazi Gjinore dhe përfaqësuesit e organizatës Women 4 Women kanë mbajtur një sesion informues për gratë e

Komunës së Drenasit në kuadër të projektit “I SEE” të përkrahur nga organizata “Gratë për gra” (Women 4 Women) dhe i implementuar në bashkëpunim me Drejtorinë e Zhvillimit Ekonomik. Në takim, drejtoresha për Zhvillim Ekonomik, Egzona Jetullahi përshëndeti gjithë të pranishmit dhe i inkurajoi që të gjitha gratë e interesuara të bëhen pjesë e këtij projekti i cili ka për qëllim përmirësimin e mundësive për vetëpunësim.

Kushtrim Shehu dhe përfaqësuesit e organizatës Women 4 Women falënderuan Komunën e Drenasit për bashkëpunimin e deritashëm dhe inkurajuan gjithë të interesuarat të bëhen pjesë e këtij projekti. i cili ka për qëllim kryesor përmirësimin e pozitës së grave të marginalizuara për tejkalimin e pengesave për përfshirje në ekonomi dhe në tregun e punës duke ngritur kapacitetet profesionale të tyre. Përmes këtij projekti do të përshtatet nevoja dhe kërkesa për trajnime profesionale të akredituara në sektorë ku ka potencial të punësimit duke ekuilibruar kërkesën dhe ofertën. Po ashtu projekti do t’i ofrojë përfituesve shërbime në ndërmjetësim në punësim dhe këshillim.



Për më tepër në vazhden e këtij bashkëpunimi me dt. 11.12.2020 Drejtoresha për Zhvillim Ekonomik së bashku me Drejtorin për Arsim kanë pritur në takim Kushtrim Shehun, koordinator i organizatës “Women for Women” I cili ka falënderuar Komunën e Drenasit për bashkëpunimin e treguar në realizimin e këtij projekti dhe ka informuar të pranishmit se një numër i caktuar i përfituesve kanë përfunduar trajnimin 4 mujor dhe në bashkëpunim me DKA-në do të ju mundësohet edhe pjesa praktike në institucionet arsimore .

Ndër të tjera në kuader të kësaj Drejtorie në fazat fillestre egziston edhe një mundësi tjetër për grat ndërmarrëse në Komunën së Drenasit ku Fondacioni i Mileniumit i Kosovës (MFK) dhe programi Grratë Ndërmarrëse në Energji (WEE) kanë hapur thirrje për grante . Ky program do të shpërndajë grante për të ndihmuar gratë ndërmarrëse të investojnë në masa të efijencës së energjisë për t'i mundësuar atyre që të rrisin biznesin e tyre përmes një përdorimi më efijent të energjisë. Thirrja për aplikime është e hapur tani për dy lloje të granteve: **Grantet e komponentit të AVANCUAR** - përqendrohen në investime deri në 10,000 €, për bizneset në pronësi të grave (të paktën 51% në pronësi të grave) dhe ndërmarrëseve individuale, pa ndonjë kufizim në numrin e të punësuarve, të cilat kanë qenë në biznes për të paktën 1 vit. Aplikimet për grante të AVANCUARA janë të hapura deri më **31 janar 2021**. **Grantet e komponentit të MENÇUR** janë përqendruar në investime që variojnë nga 10,000 € dhe deri në 135,000 €, për gratë që zotërojnë të paktën 51% të biznesit të tyre, me të paktën 5 punonjës dhe të cilat kanë qenë në biznes për të paktën 2 vjet. Aplikimet për grantet e MENÇURA janë të hapura deri më **31 janar 2021**.

19 tetor – 18 nëntor 2020 - ZBGJ në Drenas si rezultat i situates së krijuar si pasoj e pandemisë në mënyrë simbolike shënon **fushatën kundër Trafikimit me Qenje Njerëzore** , ku në kuadër të kësaj fushate është bërë publikimi i animacionit i cili i referohet fushatës në fjalë në mënyrë që sado pak të kontribojmë në vetëdijsimin e qytetarëve dhe fuqizimin e ndërgjegjësimit mbi fenomenin në fjalë .

Lidhur me fushatën **“16 Ditët e Aktivizmit kundër dhunës në familje”** Komuna e Drenasit përkatësisht Zyra për Barazi Gjinore në bashkëpunim me Qendren për promovimin e të Drejtave të Grave ka realizuar akivitetet e saja lidhur më këtë fushatë ku në këtë drejtim gjatë mbledhjes së

rregullt të Kuvendit ende pa filluar me pikat e rendit të mbledhjes antarëve të kuvendit u janë shpërndarë fjongo dhe maskë me ngjyrën që simbolizon fushatën sensibilizuese kundër dhunës në familje të cilat kanë qenë donacion nga QPDG-ja e gjithashtu para të pranishmëve është mbajtur një fjalim lidhur me këtë qështje e cila paraqitet mjaft problematike në vendin tone nga njëra prej asambleistëve të kuvendit si mënyra më e mirë e vetëdijimit të qytetarëve e në të njejtën kohë duke u bërë kështu zëri më i fuqishëm i viktimave të dhunës në familje .


.Gjithashtu në Qendrën për Punë Sociale me drejtorin e kësaj qendre dhe zyrtaret e shërbimeve sociale është mbajtur takim lidhur me ndihmën të cilën e ofrojnë ata për viktimat e dhunës në familje, me cilat vështiresi dhe sfida përballen gjatë punës së tyre lidhur me këto raste.

Gjatë këtij takimi u diskutua edhe lidhur me rastet të cilat janë trajtuar nga Organi i Kujdestarisë i QPS-së ku gjatë vitit 2020 ka trajtuar rastet e dhunës në familje me çrast ka ofruar të gjitha shërbimet e nevojshme për këtë kategori. Gjithsej kanë trajtuar 53 raste të dhunës në familje. 45 raste kanë qenë dhunë e ushtruar nga burri, dhe kryesisht kanë qenë lloj i dhunës fizike e psiqike . Gjithashtu gjatë vitit 2020 Organi i Kujdestarisë ka arritur që të sanoj gjendjen e 16 rasteve të dhunës në familje kurse rastet e tjera janë në procedure gjyqësore .





Drejtoria Komunale e Arsimit-DKA Komuna e Drenasit gjatë vitit 2020 ka ndarë gjithësej 213 bursa për nxënësit /studentët ku prej tyre 160 bursa janë ndarë sipas konkursit të rregullt nga të cilat 129 janë femra ndërsa 52 bursa janë shpërndarë përmes subvencioneve nga të cilat 34 janë femra. Studentët përfitues të bursës komunale për vitin akademik 2020/2021 kanë nënshkruar kontratat për marrjen e bursës të ndara nga Komuna në vlerë prej 500 € për një student. Me rastin e nënshkrimit të kontratave, morën pjesë kryetari i Komunës, Ramiz Lladrovci, nënkryetari Nazmi Hasi Drejtori i DKA –Së si dhe anëtarët e komisionit të cilët kanë bërë vlerësimin e aplikuesve për bursë.



Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural /Komuna e Drenasit gjatë vitit 2020 ka përkrahur fermerët e Komunës së Drenasit përmes disa projekteve :

Kjo drejtori në kuader të projektit **Furnizimi I fermerëve me serra tunel + Memorandum Bashkpunimi për ndërtimin e 5 serrave për grate e margjinuara** ka ndarë gjithsej 70 serra tipi tunel nga të cilët 29 prej këtyre përfituesve kanë qenë femra ,

Në kuader të projektit **Furnizimi i Fermerëve me Centrifugë Mekanike** janë ndarë gjithësej 60 centrifugë në pjesën e parë prej të cilëve 13 janë përfituese femra si dhe 19 centrifugë në pjesën e dytë prej të cilëve 6 janë femra .

.Gjithashtu nga ana e kësaj Drejtorie është realizuar edhe projekti **Furnizimi I Fermerëve me Mikser për ushqimin e kafshëve** nga i cili projekt përfitues kanë qenë 14 fermer nga të cilët 2 aplikues kanë qenë femra të cilat edhe kanë qenë përfituese të këtij projekti .





Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport (DKRS) në bashkëpunim me Organizatën ACCESS në kuadër të programit: “Trajnime profesionale për qasjen e te rinjve në tregun e punës”, mbështetur nga Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit, ka organizuar sot ceremoninë e certifikimit për 30 të rinj të komunave Drenas dhe Vushtrri. Në këtë ceremoni i pranishëm ishte edhe Drejtori i Departamentit për Rini në kuadër të MKRS z. Xhevat Bajrami.

Të rinjtë e certifikuar kanë përfituar në ngritje të kapaciteteve të tyre në fushën e ndërmarrësisë dhe të të bërit biznes përmes teknologjisë informative. Këta të rinj do të kenë mundësi të aplikojnë në MKRS për start-up biznese, duke e rritur kështu mundësinë për punësim dhe mirëqenien të të rinjve.





Kjo drejtori gjatë vitit 2020 ka mbështetur me subvencione disa prej OJQ-ve në kuader të të cilave në formë direkte ose involvuese ishin gratë/vajzat .

Disa nga këto OJQ janë :Shotë Galica ,Shqipet e Drensicës , SHKA “Komorani” 50-50% Meshkuj-Femra , KVRL(Këshilli I Veprimit Rinor Lokal) 50-50% Meshkuj-Femra , KV “Feronikeli “ , Klubi I Shigjetaris Feronikeli , Klubi I ngjitjes Ketrat , Shoqata e të Shurdhëve , Klubi I Shahut të Femrave si dhe KV ‘Gryka ‘ .

Gjithashtu kur jemi tek subvencionet është me rendësi të potencohet se edhe Drejtoria e Shëndetësis dhe Mirëqenjës Sociale përmes shpalljes publike për subvencionim ka mbështetur Shoqatën e Personave me aftësi të kufizuara “HANDIKOS”

Memorandum Bashkëpunimi me Organizatën “Help” - Komuna e Drenasit në fillim të këtij viti, ka nënshkruar memorandum bashkëpunimi me organizatën “Help” për mbështetjen financiare të bizneseve në Drenas. Në kuadër të këtij memorandumi janë ndihmuar bizneset fillestare dhe ato ekzistuese me pajisje të ndryshme, sipas planit të aplikuar nga vetë bizneset (gjithësej 35 biznese perfituese nga të cilat 13 janë femra).

Në kuadër të këtij bashkëpunimi Komuna e Drenasit është vlersuar nga ana e kësaj organizate për bashkëpunim të mire duke dhuruar mirënjohje e gjithashtu duke shtuar se bashkëpunime të tilla për t’i ndihmuar bizneset, do të ketë edhe në të ardhmen .





Memorandum mirëkuptimi me Zyren për ndihmë Juridike Falas – Kryetari i Komunes z. Ramiz Lladrovci ka nënshkruar memorandum mirëkuptimi me zyren për ndihmë juridike falas , qëllimi i këtij memorandum është sigurimi i qasjes së barabartë në drejtësi për qytetarët, duke siguruar qëndrueshmërinë e zyrave mobile për ndihmë juridike falas, si dhe përkushtimin e palëve për mbështetjen e zyrtarëve të ndihmës juridike të ANJF-së për të kaluar në buxhetin e Kosovës nga 1 janari 2021 dhe në vazhdim.

Memorandum mirëkuptimi me Organizaten rinore “Akti” – Kryetari i Komunës z. Ramiz Lladrovci ka nënshkruar memorandum mirëkuptimi me Organizatën rinore Akti për realizimin e projektit “përfshirja sociale dhe fuqizimi ekonomik i të rinjve dhe familjeve, përmes masave për krijimin e të ardhurave”.

Ky projekt bashkë implementohet me SOS Fshatrat e Fëmijëve në Kosovë, ndërsa financohet nga The German Federal Ministry for Economic Cooperation and Development (BMZ) dhe Hermann-Gmeiner Fund Germany (HGFD).

Qëllimi i këtij projekti është që të kontribuojë drejtë përmirësimit të perspektivave të punësimit, mirëqenies sociale dhe ekonomike të të rinjve dhe familjeve në Komunën e Drenasit përmes përfshirjes së tyre në tregun e punës.



Ndër të tjera vlenë të potencohet që Komuna e Drenasit në vazhdimësi është vlerësuar për përfaqësim gjinor në nivel lokal dhe mbi të gjitha Qeverisja e mirë e kryetarit Ramiz Lladrovci në Komunën e Drenasit, për vitin 2019, është vlerësuar për performancën më të mirë, kampion në mesin e komunave dhe është shpërblyer me grant me vlerë 803.000 euro nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal .



E autorizuar
Arlina Mulaj, ZBGJ Drenas